



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.912/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike në kontestin tregtar-administrativ të paditësit-propozuesit “Bora BB”, SH.P.K me seli në Prishtinë, rr. “Shkupi”,OB.A, Linda Premium Residence L9 pn, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “Vokshi& Lata”, me adresë në rr. “ Holger Petersen”, Objekti “Park Residence” Hy. 4.2, Prishtinë, kundër të paditurës-kundërpropozuesit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit-propozuesit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.171/24, të datës 27.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e paditësit-propozuesit “Bora BB”, SH.P.K me seli në Prishtinë, ndërsa anulohet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.171/24, të datës 27.03.2024 dhe lënda i kthehet në Gjykatën Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, me Aktvendimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka vendosur: REFUZOHET propozimi-kërkesa e Bora BB”, SH.P.K me seli në Prishtinë, përmes të cilës ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar - vendimit me nr.prot. 60/24/23 të datës 06.03.2024, të të paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë.

Procedura sipas padisë në këtë konflikt administrativ do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës në kontestin tregtar-administrativ dhe sipas planit të punës së Gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjës faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit/propozuesit si e bazuar, dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar si dhe të aprovohet kërkesa e paditësit-propozuesit.

E paditura-kundërpropozuesi nuk ka paraqit përgjigje në ankesë edhe pse ankesën e ka pranuar me datën 16.04.2024.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar kërkesën e paditësit/propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se nuk ka gjetur asnjë provë të vetme, me të cilën do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ në këtë rast. Propozuesi në kërkesën për shtyrje të ekzekutimit, nuk ka dëshmuar se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, se ekziston rreziku i shkakut të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues.

Gjykata në shkallë të parë duke vlerësuar propozimin - kërkesën e paditësit dhe shkresat e lëndës e të cilat në tërësi u referohen vetëm pretendimeve të padisë ka konstatuar se propozuesi i masës nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë konkrete se ekzekutimi i vendimit kontestues, do të

mund ti shkaktonte ndonjë dëm të pariparueshëm, e i cili do të mund të riparohej me vështirësi, ashtu siç është përcaktuar me nenin 22, paragrafi 6, e lidhur me paragrafin 2, të këtij neni, të LKA-së. Prandaj, gjykata vlerëson se propozimi - kërkesa e paditësit për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar - vendimit të të paditurës nr.prot. 60/24/23 të datës 06.03.2024, është e pa bazuar.

Gjykata e Shkallës së parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se kërkesa për shtyrje e ekzekutimit të vendimit duhet ti plotësojë në mënyrë kumulative tri kushte ligjore, ashtu siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 22 par. 6 lidhur me paragrafin 2 të këtij neni të LKA-së. Ndër të tjera ka theksuar se ajo duhet të jetë e besushme, ashtu që kërkesa të përfshijë mundësinë e rrezikut të menjëhershëm dhe të pariparushëm, në radhë të dytë ajo nuk duhet të jetë në kundërshtim me interesin publik, dhe në radhë të tretë e njejta nuk duhet ti shkaktoj ndonjë dëm palës kundërshtare. Po ashtu në aktvendimin e ankimuar ka cek se gjykata nuk gjetë dëshmi me të cilën do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ në këtë rast, edhe përkundër faktit se propozuesi ka bashkangjitur dëshmi nga banka BKT, NLB, Banka Ekonomike dhe ProCredit Bank lidhur me kreditë bankare, gjykata të njejta nuk i morri për bazë për vlerësuar se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i pariparushëm, se ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues, e nga të cilat shihet se këtu propozuesi ka bilanc financiar pozitiv, andaj propozuesi /paditësi nuk ka ofruar dëshmi të cilat do ta mbështesnin pretendimin e propozuesit se ekziston mundësia e shkaktimit të dëmeve apo humbjeve të tilla, përkatësisht për cilat arsye shtyrja e ekzekutimit është e domosdoshme. Krejt në fund aktvendimin e saj e ka mbështet në nenin 22 paragrafi 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe nenit 27 par 1 të Ligjit për Gjykatës Komerciale.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë duke ekzaminuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese tani për tani është i pa papranushëm, për arsye se ka gjetur se aktvendimi i ankimuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika n) e që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktvendimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, sepse në arsyetim nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare

respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, me të cilën aktvendimi në tërsi bëhet i pakuptueshëm dhe nuk është në harmoni me dispozitvin e aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar fare nëse janë plotësuar kushtet nga neni 22 par.2 i LKA-së, por në tërë arsyetimin e aktvendimit të ankimuar vetëm ka përshkruar dispozitat e nenit 22 par.2 të LKA-së, por nuk është dhënë asnjë fakt i vërtetuar dhe asnjë arsye pse gjykata ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga dispozita e lartëcekur.

Sipas nenit 22 nën pikën a) dhe b) të LKA-së parashihet se: “a) ekzekutimi do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik; c) shtyrja nuk do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Bazuar në dispozitat e sipërcituara për shtyrje të ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen kushtet ligjore në mënyrë kumulative, mirëpo në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar nuk janë dhënë fare arsye lidhur me atë se pse nuk janë plotësuar kushtet sipas dispozitës së lartëcekur. Madje në arsyetim gjykata e shkallës së parë thekson se paditësi në bazë të dëshmimeve të cilat i ka bashkangjitur propozuesi në shkresa të lëndës sic janë kontrata për kreditë bankare, plani i pagesave për kthimin e kredisë, kontratat noteriale të hipotekës, kontrata mbi financimin e shitblerjes së pronës së paluajtshme, plani i pagesave për kthimin e kësaj kredie, lista e llogarive të pagueshme deri me datë 31.12.2023, raporti i auditimit, pasqyrat e llogarive bankare nga banka BKT, NLB, Banka Ekonomike dhe ProCredit Bank lidhur me kreditë bankare ka bilanc financiar pozitiv, mirëpo nuk ka sqaruar se cka nënkupton me bilanc financiar pozitiv apo të favorshëm. Kjo gjykatë vlerëson se nuk është i mjaftueshëm vetëm vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë se paditësi ka bilanc financiar pozitiv, pa i trajtuar në mënyrë konkrete dëshmit e paditësit, për tu vërtetuar fakti se paditësi a ka mundësi të mjaftueshme financiare të përballoj apo jo një detyrim tatimor sikurse është përcaktuar nga e paditura, i cili detyrim do të mund ti shkaktonte paditësit dëm të pariparueshëm.

Andaj, në riprocedurë gjykata e shkallës së parë fillimisht ti vlerësoj të gjeturat nga kolegji si dhe ti vlerësoj dhe të analizoj të gjitha provat e paraqitura nga paditësi, dhe pastaj varësisht nga vlerësimi i provave në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ashtu që lidhur me masën e propozuar të vendos drejt dhe sipas Ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën d) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.912/24, data 23.04.2024

Kryetarja e kolegjit-Saranda Bogaj Sheremeti, d.v